

# DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

INICO NJË MUNDËSI  
PËR TË GJITHË:

QASJE E DREJTË  
PËR MUNDËSI PËR TË  
GJITHË TË PAPUNËT



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN



Këshilli Rinor Nacional  
i Maqedonisë



Dokument për  
politika publike

**INICO NJË MUNDËSI PËR TË GJITHË:**

**QASJE E DREJTË  
PËR MUNDËSI  
PËR TË GJITHË  
TË PAPUNËT**

*Botues:*

Këshilli rinor nacional i Maqedonisë  
rr. Veljko Vlahovikj, nr. 7/1-1, 1000 Shkup  
www.nms.org.mk  
info@nms.org.mk

*Për botuesin:*

Bojan Petrovski, kryetar

*Autorë:*

Filip Kulakov  
Vesna Radinovska

*Dizajn dhe shtyp:*

Digi Print

*Tirazhi:*

150 kopje

*Viti i botimit:*

2020

Nisma e Këshillit rinor nacional të Maqedonisë (KRNM) «Inico një mundësi për të gjithë» mbështetet nga Programi për forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset legjislative 2018-2020, e udhëhequr nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), me mbështetje financiare nga Agjencioni për zhvillim ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky botim është përgatitur nga autorët dhe me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencionit për zhvillim ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për zhvillim ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Këshilli Rinor Nacional  
i Maqedonisë

## RRETH KRNM

*Këshilli rinor nacional i Maqedonisë* është një platformë që përfaqëson interesat dhe nevojat e të rinjve si një lidhje midis të gjitha palëve të interesuara dhe e cila siguron përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në çdo nivel. KRNM u themelua me 29 qershor 2013 nga 55 organizata.

KRNM është një organ përfaqësues i organizatave rinore në Maqedoninë e Veriut. Këshilli bashkon federata, organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, degët rinore të organizatave të tjera me qëllim të promovimit dhe përfaqësimit të të rinjve dhe të drejtave të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Anëtarësia e KRNM është e larmishme, duke bashkuar organizata që veprojnë në nivel nacional dhe rajonal, zona rurale dhe urbane, organizata studentore, degë të organizatave ndërkombëtare dhe lloje të tjera të shoqatave. Në procesin e arritjes së qëllimeve të saja, KRNM përfaqëson interesat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh statusin e tyre socio-ekonomik, gjininë, racën, origjinën etnike dhe kulturore, bindjet politike dhe fetare, orientimin seksual, identitetin gjinor ose ndonjë tjetër formë të dallimit.

## PËR NISMËN

Nisma “Inico një mundësi për të gjithë” është pjesë e Programit të Institutit Nacional Demokratik (NDI) për Forcimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset legjislative, me mbështetje financiare nga populli Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për zhvillim ndërkombëtar (USAID). Qëllimi i nismës legjislative është që të ndryshojë mënyrën e regjistrimit të të rinjve të papunë (punëkërkues aktivë) në APRMV të cilët sipas Ligjit aktual për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë janë të obliguar që personalisht të paraqiten në Agjenci çdo 30 ditë.

## PËRMBAJTJA

LISTA e SHKURTESAVE .....	6
HYRJE .....	7
KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE.....	9
Legjislacioni aktual.....	9
Praktika institucionale.....	10
EKSPERIENCA E KRNM ME GARANCINË RINORE .....	12
MODELE KRAHASUESE TË REGJISTRIMIT NGA RAJONI.....	16
Shqipëria.....	16
Bosnjë dhe Hercegovina.....	17
Kosova .....	18
Sllovenia .....	19
Serbia.....	20
Mali i Zi.....	21
Shfaqja grafike .....	22
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	24
ZGJIDHJA LIGJORE .....	27

## LISTA e SHKURTESAVE

**APRMV** - Agjencia e punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**GR** - Garancia rinore

**LPSP** - Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë

**KRNM** - Këshilli rinor nacional i Maqedonisë

**eID** - identifikimi elektronik

**NDI** - Instituti Nacional Demokratik



## HYRJE

Pas përfundimit të arsimit, të gjithë të rinjtë, para se të hyjnë në tregun e punës, së pari aplikojnë në qendrat e punësimit të Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: APRMV). Bëhet fjalë për një procedurë administrative në të cilën për herë të parë secili person hyn në evidencën e personave të papunë dhe fiton një varg të caktuar të drejtave dhe mundësive. Kjo procedurë është e rregulluar me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

Sipas nenit 59-a i Ligjit për punësimin dhe sigurim në rast të papunësisë, "Personi i papunë duhet që të paraqitet personalisht në Agjenci çdo 30 ditë dhe të dëshmojë se ai/ajo në mënyrë aktive ka kërkuar punë gjatë muajit të fundit, dhe një person tjetër që kërkon punë çdo gjashtë muaj. „

Sipas nenit të përmendur, regjistrimi personal shkakton vështirësi për të rinjtë dhe institucionet, veçanërisht për sa i përket:

- ◆ Kufizimit të mundësisë së përfshirjes në masën Garancia rinore, duke pasur parasysh që kushtet për përfshirje në të parashikojnë që personat e interesuar të aplikojnë për herë të parë në APRMV në vitin aktual, dhe në mënyrë aktive të konfirmojnë statusin e tyre çdo muaj, përndryshe të njëjtat do të fshihen.
- ◆ Procesi i regjistrimit të të gjithë personave të papunë në APRMV të cilët për shkak të mungesës së informacionit, vështirësive financiare, gjeografike dhe vështirësive të tjera nuk janë në gjendje të raportojnë fizikisht në zyrat e APRMV çdo 30 ditë.
- ◆ Evidenca e personave të papunë, pasi që sistemi aktual i evidentimit të personave të papunë nuk i merr parasysh rrethanat ose arsyet se pse punëkërkuuesit nuk kanë arritur që të regjistrohen në APRMV brenda 30 ditëve. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të posedohen shifra dhe informacione valide dhe të vërteta, në mënyrë që politikat publike të punësimit të jenë të sakta, efikase dhe reale.

Bazuar në atë sipër, Këshilli rinor nacional i Maqedonisë propozon ndërhyrje në tekstin ligjor të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, me atë që besojmë se duhet të futen mekanizma alternative për regjistrim dhe konfirmim të statusit të punëkërkuesit aktiv në APRMV, të cilët do të plotësonin metodën e regjistrimit mujor, në mënyrë që personat të mos obligohen që personalisht të vizitojnë Qendrën e punësimit çdo 30 ditë.

## KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

### Legjislacioni aktual

Në legjislacionin nacional të Republikës së Maqedonisë së Veriut, procesi i evidentimit, regjistrimit, si dhe fshirja e punëkërkuësve nga evidenca rregullohet me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

Në kuadër të Kapitullit 3: Mënyra e mbajtjes së evidencës, regjistrimit dhe fshirjes së personit nga evidenca, është neni 59-a, i cili rregullon këtë çështje.

#### Neni 59-a

**Personi i papunë është i obliguar që personalisht të paraqitet në Agjenci çdo 30 ditë dhe të dëshmojë se ai/ajo në mënyrë aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit, dhe një person tjetër që është duke kërkuar punë çdo gjashtë muaj.**

Personi i papunë i cili nuk arrin të përmbushë obligimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni brenda 30 ditëve pas skadimit të periudhës për paraqitje i përcaktuar në planin individual të punësimit, fshihet nga evidenca e personave të papunë dhe mund të aplikojë përsëri pas një viti, ndërsa shfrytëzuesit e të drejtave të papunësisë e humbin të drejtën.

Personi i papunë i cili referohet nga Agjencia tek një punëdhënës për punësim dhe nuk paraqitet ose refuzon të krijojë marrëdhënie pune në një punësim adekuat ose të përshtatshëm në pajtim me këtë ligj, ose refuzon trajnimin, rikualifikimin ose kualifikimin plotësues për punësim, fshihet nga evidenca e personave të papunë dhe mund të ri-aplikojë përsëri pas një viti.

Personi i papunë i cili nuk i respekton obligimet e ndërmarra në planin individual të punësimit, fshihet nga evidenca e personave të papunë dhe mund të aplikojë përsëri pas skadimit të një viti.

Një person i cili nuk do të pranojë trajnim dy herë në dy vjet, fshihet nga evidenca e personave të papunë. Personi i papunë i cili nuk arrin të njoftojë Agjencinë për ndryshimet që ndikojnë në fitimin dhe humbjen e të drejtave dhe nga organi i inspektimit hetohet se është duke punuar në mënyrë të paligjshme ose refuzon të punësohet për të kryer punë publike, do të fshihet nga evidenca e personave të papunë dhe mund të aplikojë përsëri pas një viti. Organi i inspektimit për këta persona është i obliguar të njoftojë me shkrim Qendrën për punë sociale dhe Agjencinë.

Personi i papunë që vërehet nga organi i inspektimit se është duke punuar kundër ligjit kryen një vepër penale

## Praktika institucionale

Për shkak të situatës me koronavirusin në fillim të vitit 2020<sup>1</sup>, më 1 prill të vitit të njëjtë, Agjencia e punësimit lëshoi një njoftim se regjistrimi i rregullt i të papunëve çdo 30 ditë, respektivisht 6 muaj (duke përfshirë këtu edhe shfrytëzuesit e kompensimit financiar dhe shfrytëzuesit e ndihmës financiare sociale) pezullohet deri në skadimin e masave të marra për mbrojtje nga infeksioni i koronavirusit dhe e njëjta do të justifikohet.

Në njoftim u tha se personat, punësimi i të cilëve ishte ndërprerë në periudhën e kaluar të vlefshmërisë së masave, si dhe ata persona që duhet të regjistrohen si të papunë për herë të parë, mund të paraqiten në Qendrat kompetente të punësimit.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Organizata botërore e shëndetësisë e shpalli KOVID-19 për pandemi me 11 mars, 2020. Masat e miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të parandaluar përhapjen e KOVID-19 mund të gjinden në tërësi në lidhjen vijuese: <https://vlada.mk/covid19>

<sup>2</sup> Faqja e internetit e Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut: <https://www.vrabortuvanje.com.mk/Vest/6847/Soopshtenie-od-Agencija-za-vrabortuvanje/67/>

Në këtë mënyrë, APRMV tregon se nevojiten modifikime në mënyrën e regjistrimit të të papunëve. Sidoqoftë, me futjen e kësaj praktike, në mungesë të mundësisë për regjistrim elektronik të të papunëve, Agjencia sillet në një situatë ku nuk ka burim të besueshëm të të dhënave për numrin e punëkërkuësve.

## EKSPERIENCA E KRNIM ME GARANCINË RINORE

Garancia rinore (Youth Guarantee) është një grup masash qeveritare që synojnë të garantojnë shërbime cilësore të ofruara për të rinjtë në drejtim të punësimit, arsimit të vazhdueshëm, arsimin plotësues, praktikës dhe trajnimit.

Si model, Garancia rinore është vërejtur për herë të parë në Finlandë dhe Skandinavi në vitet e 80'ta dhe 90'ta. Me kalimin e viteve, vërehen forma të ndryshme të këtij modeli në vende të ndryshme, sipas natyrës dhe nevojave të ndryshme të tregut të punës.

Në nivelin e Bashkimit Evropian, Garancia rinore në vitin 2012 bëhet pjesë e rekomandimeve për rritjen e punësimit të të rinjve deri në moshën 25 vjeçare në shtetet anëtare, të propozuara nga Komisioni Evropian, me propozimin e Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian.

Republika e Maqedonisë së Veriut po përballet me një problem të gjatë me dekada, me një shkallë të lartë të papunësisë së të rinjve. Shkalla aktuale e papunësisë së të rinjve është 47,6 %<sup>3</sup> dhe është një shkak i drejtpërdrejtë i dëshirës së madhe për emigrim, pakënaqësisë dhe apatisë së të rinjve në Maqedoninë e Veriut.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke ndjekur praktikën evropiane në vitin 2018, filloi me zbatimin e politikës publike „Garancia rinore“ (GR) në mënyrë që të sigurojë të rinjtë (15-29) të cilët nuk janë në arsim, nuk janë të punësuar dhe nuk janë në trajnim (not in education, employment nor training - NEET), një ofertë për punësim, arsim dhe trajnim të vazhdueshëm, ose punë praktike për një periudhë prej katër muajsh pasi që të mbeten të papunë ose të lënë shkollën. Kushti për regjistrim në Garancinë rinore është që të jetë regjistrimi i tyre i parë në APRMV, të jenë

---

<sup>3</sup> F. 57, World Bank Group Western Balkans Regular Economic Report No.14 Higher But Fragile Growth 2018

të papunë dhe të pa angazhuar. Plani i zbatimit të GR është parashikuar në dy faza:

◆ **Faza 1** (2018-2019). Gjatë fazës së parë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- ◆ prezanton reformat e politikave të nevojshme për të mundësuar zbatimin e GR;
- ◆ bën hartëzimin e të rinjve të paangazhuar dhe nevojat e tyre, por gjithashtu edhe vlerëson investimin e nevojshëm për realizimin e plotë të GR;
- ◆ themelon partneritete për të arritur deri te të rinjtë e pa angazhuar;
- ◆ zgjeron përfshirjen e shërbimeve dhe programeve që janë në dispozicion;

piloton zbatimin e Garancisë rinore në tre qendra punësimi pilot duke zbatuar masa të duhura për punësim dhe shërbime në tregun e punës që përputhen me nevojat e të rinjve që nuk janë të punësuar ose të përfshirë në arsim ose trajnime.

- ◆ krijon një sistem për monitorimin dhe sigurimin e informatave kthyesë nga procesi i zbatimit.

◆ **Faza 2** (2020-2022). Faza e dytë e zbatimit të GR mund të fillojë vetëm kur të futen reformat kryesore të politikave të përshkruara më sipër. Kryesisht shërben për të rregulluar mekanizmat institucionale për koordinim për të forcuar sigurimin e shërbimeve të integruara të GR dhe zbatimin e GR për të gjithë NEET-et e rinj (15-29) në vend.

Bartësi kryesor i kësaj politike është Ministria e punës dhe politikës sociale dhe zbatohet në partneritet me Agjencinë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshillin rinor nacional të Maqedonisë, përfshirë edhe Ministrinë e arsimit dhe shkencës (MASH), Agjencinë për rini dhe sport (ARS), Qendra për arsimin e të rriturve (QARr), Qendra për arsimin e mesëm profesional (QAMP) dhe institucione të tjera<sup>4</sup>.

<sup>4</sup> Master plani për Garancinë rinore, (2018)

Për nevojat e Garancisë rinore, është përgatitur një Master plan (plan kryesor) për zbatim, një Plan veprimi për zbatimin e Garancisë rinore për vitin 2018, është krijuar edhe një Trup koordinues për zbatimin e Garancisë rinore, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve nga pushteti ekzekutiv dhe KRNМ.

Në kuadër të Garancisë rinore, roli i KRNМ ishte të organizojë dhe të ofrojë shërbime për punë në terren për të rinjtë e papunë dhe t'i ndihmojë që ata të regjistrohen në sistemin e sigurimit të shërbimeve për Garancinë. Respektivisht, bëhet fjalë për një grup të rinjve që përfshijnë të papunët afatgjatë, të rinjtë që sapo po hyjnë në tregun e punës, ata që përkohësisht vuajnë nga ndonjë sëmundje, ata që jetojnë me aftësi të kufizuara ose thjesht bëjnë një pushim nga puna ose arsimi.

Bazuar në përvojat nga puna në terren, KRNМ lokalizon nenin 59-a të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast papunësie dhe zbatimin e tij, si veçanërisht të pafavorshëm për kategoritë më të prekshme, të cilat janë gjithashtu grupi i synuar i masës së Garancisë rinore. Në vetëm një muaj kalendarik të realizimit, 170 të rinj të cilët u regjistruan në Garancinë rinore, për shkak të mosparaqitjes në Qendrën e punësimit u fshinë nga evidenca dhe nga Garancia rinore. Disa nga ata persona të regjistruar nuk kishin marrë një ofertë nga APRMV brenda afatit kohor të parashikuar nga Garancia rinore (4 muaj nga regjistrimi në APRMV). Arsyeja kryesore e mos raportimit është situata socio-ekonomike e këtyre të rinjve, mosbesimi në institucione dhe pamundësia për të mbuluar koston e udhëtimit në qendrat e punësimit, veçanërisht ato që vijnë nga zonat rurale të komunave. Të rinjtë që do të fshihen nga regjistri i punëkërkuësve aktivë, humbasin të drejtën për t'u përfshirë në Garancinë rinore, për dy arsye:

- ◆ Garancia parashikon që personat të marrin një ofertë për të hyrë në një nga masat brenda 4 muajve, dhe me vet faktin që fshihen pas muajit të parë nuk kanë mundësi të marrin ofertë në afatin e dhënë;
- ◆ Në Garancinë rinore mund të hyjnë vetëm ata të cilët për herë të parë janë paraqitur në APRMV në vitin aktual, nga vet fakti që ata do të fshihen pas muajit të parë, personat automatikisht e humbin këtë status pas fshirjes.



Në raportin e fundit vjetor të Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>5</sup>, përkatësisht raporti për vitin 2018, kur Garancia për të rinjtë filloi të zbatohej, thuhet se “Suksesi i Garancisë rinore për vitin 2018 është 41%”. Raporti nuk tregon arsyet për një përqindje relativisht të ulët, por ne besojmë se nëse do të kishte një mënyrë tjetër për paraqitjen e të papunëve, në vend se personalisht dhe në baza mujore, suksesi i Garancisë do të ishte dukshëm më i lartë.

Për më tepër, edhe vet Komisioni Evropian në raportin e tij të fundit për vendin, botuar më 29 maj 2019,<sup>6</sup> thekson rëndësinë e Garancisë rinore. Konkretisht, raporti thekson: “Për të përmirësuar funksionimin e ekonomisë së tregut, Maqedonia e Veriut duhet në veçanti të zbatojë Garancinë rinore në mbarë territorin e vendit, veçanërisht në rajone që janë më pak të zhvilluara.” Ky është vetëm një tregues tjetër i rëndësisë së madhe të zbatimit sa më efektiv të Garancisë rinore, jo vetëm për të përmirësuar standardin e jetesës dhe në përgjithësi, kushtet e jetesës për të rinjtë e papunë, por edhe në perspektivë, për proceset e integritimit Evropian të vendit.

---

<sup>5</sup> Raporti vjetor i APRMV për vitin 2018, në dispozicion në: <https://av.gov.mk/content/Dokumenti/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%90%D0%92%D0%A0%D0%A1%D0%9C%202018.pdf>

<sup>6</sup> Në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

## MODELE KRAHASUESE TË REGJISTRIMIT NGA RAJONI

### Shqipëria

Shërbimet të cilat personat e papunë i marrin nga agjencia kompetente në Shqipëri mund të ndahen në tre kategori: informacion mbi vendet e lira të punës; ndërmjetësim në punësim dhe këshilla për orientim në karrierë.<sup>7</sup> Në Shqipëri, sipas platformës së Agjencisë së punësimit të Shqipërisë, punëkërkuessit e papunë duhet që personalisht të regjistrohen në zyrat e punësimit të cilat janë në dispozicion në secilën bashki, një herë në muaj, ose më shumë, në varësi të asaj se sa herë thirren nga ky institucion. Gjatë secilës paraqitje të tyre, është e nevojshme që ata të sjellin dokumentacionin për të gjitha aplikimet për punë që ata kanë paraqitur në periudhën e kaluar.<sup>8</sup> Lidhur me fshirjen e punëkërkuessve nga evidenca, nuk ka të dhëna të disponueshme.

Në platformën elektronike (puna.gov.al), e azhurnuar nga Agjencia e punësimit e Shqipërisë, shpallen vende të reja pune dhe të interesuarit mund të aplikojnë në mënyrë elektronike. Ky opsion është i disponueshëm vetëm për njerëzit që janë regjistruar në mënyrë elektronike në platformë. Për t'u regjistruar në platformën puna.gov.al dhe për të përdorur shërbimet e ofruara nga platforma, njerëzit duhet të plotësojnë një formular të thjeshtë me të dhënat e tyre personale (Emri dhe mbiemri, adresa fizike dhe posta elektronike, data e lindjes, numri personal dhe ngjashëm). Nëse këtë e bëjnë në mënyrë korrekte dhe me sukses, të papunët marrin kredencialet për qasje në portal përmes adresës së tyre të postës elektronike. Pasi të kyçen në profilin e tyre, të papunët gjithashtu mund të ngarkojnë një CV, gjë që mund të përmirësojë ndjeshëm shanset e tyre për të gjetur një punë. Në

<sup>7</sup> Burimi: <http://www.puna.gov.al/Sistemi%20i%20Sh%C3%ABrbimeve%20t%C3%AB%20Pun%C3%ABsimit.pdf>

<sup>8</sup> <http://www.puna.gov.al/Sistemi%20i%20Sh%C3%ABrbimeve%20t%C3%AB%20Pun%C3%ABsimit.pdf>

pjesën për kërkim të punës në portalin [puna.gov.al](http://puna.gov.al), ekziston mundësi për të filtruar shpalljet aktive për punë të cilat mund të filtrohen sipas lëndës, vendndodhjes dhe datës së publikimit të shpalljes së punës. Nëse nuk keni një profil, përsëri do të jeni në gjendje të shfletoni shpalljet, por nuk do të jeni në gjendje që të aplikoni.

Të dhënat për sanksionimin e personave që nuk janë paraqitur brenda afatit të caktuar, nuk mund të gjenden në internet.

### Bosnjë dhe Hercegovina

Sipas Rregullores për evidentimin e personave të papunë në Bosnjë dhe Hercegovinë<sup>9</sup>, personi i papunë është i detyruar që personalisht dhe rregullisht të paraqitet në Shërbimin e punësimit, dhe të paktën një herë brenda:

- ◆ 30 ditëve, nëse ai/ajo përdor të drejtën për kompensim financiar si dhe sigurim invalidor dhe pensional;
- ◆ 45 ditë, nëse ai ushtron të drejtën e sigurimit shëndetësor dhe
- ◆ 120 ditë, nëse nuk përdor të drejta në rast të papunësisë.

Në nenin 5 të Ligjit për ndërmjetësim në punësimin dhe sigurim social të personave të papunë të Bosnjës dhe Hercegovinës<sup>10</sup> cekë arsyet se pse Shërbimi i punësimit pushon së mbajturi evidencë për personin e papunë. Në dispozitat e këtij ligji, si dhe të Rregullores për regjistrimin e personave të papunë, nuk thuhet se si sanksionohet mosparaqitja e personit të papunë brenda afatit të caktuar.

<sup>9</sup> Rregullorja për mbajtjen e evidencës së personave të papunësuar, Gazeta zyrtare e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës nr. 74/18 nga 19.8.2018, në dispozicion në: <https://fmrsp.gov.ba/?wpdmpo=pravilnik-o-evidencijama-u-oblasti-zaposljavanja&wpdmdl=5038>

<sup>10</sup> Ligji për ndërmjetësim në punësim dhe siguri sociale të personave të papunë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Gazeta zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës nr. 41/01, 22/05 i 9/08, në dispozicion në: <http://www.upfbih.ba/uimages/DVADESET%20ZAKONA/Zakon20o20posredovanju20u20zapoC5A11javanju20i20socialnoj20sigurnosti20nezaposlenih20osoba.pdf>

Sistemi organizativ i shërbimeve të punësimit ndjek parimin e organizimit të Bosnjë dhe Hercegovinës, respektivisht, në nivelin shtetëror në sferën e punësimit dhe punës është ngritur Agjencia për punë dhe punësim, në nivelin e entiteteve janë ngritur zyrat e punësimit, ndërsa shërbimet e punësimit janë të organizuara në nivel kantonal.<sup>11</sup>

Për më tepër, në nivel kantonal janë të rregulluara platforma të veçanta të cilat punëkërkuessve ju ofrojnë mundësi adekuate punësimi, por dispozitat ligjore për regjistrimin dhe konfirmimin e statusit të tyre vlejnjë në mënyrë të barabartë për të gjitha kantonet.

## Kosova

Në Kosovë, në përputhje me Ligjin për regjistrimin dhe ofrimin e mundësive për të papunët, punëkërkuessit dhe punëdhënësit<sup>12</sup>, është paraparë që qytetarët e moshës 18 deri 64 vjeçare të cilët nuk janë të punësuar, punojnë me orar të përgjysmuar, ose janë të pezulluar nga puna, të regjistrohen në sistemin e Agjencisë së punësimit të Kosovës. Për më tepër, ekziston mundësia që në Agjenci të regjistrohen edhe të mitur, konkretisht qytetarë të moshës 15 deri në 18 vjeç, dhe si të tillë kanë një status të veçantë në sistem.

Çdo punëkërkuess ka të drejtë të regjistrohet në sistemin e shërbimeve në internet të Agjencisë së punësimit të Kosovës për të marrë shërbime të ndërmjetësimit në punësim. Regjistrimi përmes EARS - sistemi i regjistrimit në Agjencinë e punësimit bëhet duke krijuar një profil personal në formë të CV-së. Me këtë, punëkërkuessit duhet të përdorin profilin e tyre të paktën një herë në 6 muaj. Ligji nuk përcakton sanksionin për mos përmbushjen e këtij obligimi.

---

<sup>11</sup> Burimi: [https://europa.ba/?page\\_id=664](https://europa.ba/?page_id=664)

<sup>12</sup> GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 26 / 21 korrik 2016, PRISHTINË - LIGJI Nr. 05/L -077 PËR REGJISTRIMIN DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR TË PAPUNËT, PUNËKËRKUESIT DHE PUNËDHËNËSIT [https://apr.kks.gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=3&fbclid=IwAR32bs95bMKdEFjslZT6w5MSkjjDry6jNZPa5zN\\_Gsc2IMm1B14FdjxE\\_SQ](https://apr.kks.gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=3&fbclid=IwAR32bs95bMKdEFjslZT6w5MSkjjDry6jNZPa5zN_Gsc2IMm1B14FdjxE_SQ)

Ata që janë të regjistruar në Agjencinë e punësimit të Kosovës kanë asistencë në gjetjen e një pune, trajnime të ndryshme për profilin e tyre, informacion mbi të gjitha vendet e lira të punës sipas profilit të tyre. Informacionet e tilla i marrin nga Zyrat e punësimit ose në mënyrë elektronike.

Lidhur me procesin e konfirmimit të statusit të një punëkërkuasi, personat e regjistruar në Zyrën e Punësimit janë të obliguar që të regjistrohen personalisht të paktën një herë në 3 muaj, dhe të paraqiten në Zyrën e punësimit kur të thirren nga institucioni, në mënyrë që të informohen për mundësitë dhe aktivitetet e reja në tregun e punës.

Sipas ligjit të mësipërm, nëse të papunët mungojnë në 2 regjistrime radhazi në Zyrën e punësimit, të njëjtit do të fshihen nga sistemi, por mund të ri regjistrohen sërish pa afat kohor.

### Slovenia

Në Slloveni, punëkërkuasit regjistrohen në Qendrën e punësimit në varësi të vendit ku kërkojnë punë dhe afërsisë së vendbanimit të tyre. Procesi i regjistrimit bëhet në mënyrë:

- ◆ Elektronike, përmes portalit PoisciDelo.si
- ◆ Personale, duke u paraqitur në Qendrën punësimit
- ◆ Postare, duke paraqitur një aplikim të plotësuar për regjistrim të një personi të papunë, ose një punëkërkuasi në adresën e Qendrës së punësimit.
- ◆ Përmes një përfaqësuesi të autorizuar, i cili është i autorizuar që në emër të tjerëve të ndërmarrë veprime ose procedura të caktuara.<sup>13</sup>

Kjo mënyrë e mbulimit të më shumë mënyrave të regjistrimit padyshim që rezulton në një përfshirje më të madhe të të gjithë personave të papunë, duke i lënë hapësirë atyre për të bërë një zgjedhje në mënyrën se si ata mund të përmbushin obligimin e tyre për të aplikuar.

<sup>13</sup> Ueb faqja e shërbimit sloven për punësim, në dispozicion në: [http://english.ess.gov.si/jobseekers/registration\\_with\\_the\\_ess/register-of-the-unemployed](http://english.ess.gov.si/jobseekers/registration_with_the_ess/register-of-the-unemployed)

Ligji slloven për rregullimin e tregut të punës<sup>14</sup> nuk përmban një dispozitë mbi afatin kohor brenda të cilit punëkërkuesi aktiv duhet të regjistrohet në shërbimin kompetent dhe të konfirmojë statusin e tij/saj, por thotë se personi i papunë konsiderohet se kërkon aktivisht punë nëse ai/ajo në mënyrë aktive zbaton aktivitetet e planit për punësim dhe e kontakton Shërbimin e punësimit brenda 15 ditëve nga skadimi i periudhës për kryerjen e aktivitetit të fundit të përcaktuar në planin e punësimit. Plani i punësimit është një marrëveshje me shkrim e lidhur midis personit të papunë dhe shërbimit të punësimit. Sidoqoftë, ligji nuk rregullon mënyrën se si një person bie në kontakt me Shërbimin - personalisht, elektronikisht, me postë, etj.

Sipas ligjit të mësipërm, personi i cili është një punëkërkues aktiv do të fshihet nga sistemi i evidencës së Shërbimit të punësimit nëse vetë kërkon të fshihet ose kur fare nuk e kontakton Shërbimin e punësimit brenda një periudhe prej 6 muajsh nga momenti i regjistrimit.

## Serbia

Regjistrimi në Shërbimin për punësim në Serbi bëhet ekskluzivisht personalisht, në njësitë e Shërbimit kombëtar për punësim, në varësi të vendbanimit të punëkërkuesit.<sup>15</sup>

Në rast se punëkërkuesi nuk arrin të paraqitet brenda 3 muajve në Shërbimin e punësimit, ekziston një sanksion në formën e ndalimit të regjistrimit brenda 6 muajve të ardhshëm<sup>16</sup>. Megjithatë, nëse punëkërkuesi vonohet me paraqitjen, ekziston një mundësi për të kontaktuar këshilltarin e tij/saj të karrierës, i caktuar nga Shërbimi, për ta informuar atë për situatën e krijuar, pasi që sanksionet e tilla nuk janë aq të ashpra në të gjitha komunat.

Të papunët janë të obliguar që personalisht të kontaktojnë Shërbimin kombëtar për të marrë njoftim për kushtet e punësimit dhe ndërmjetësimin

---

<sup>14</sup> Ligji për rregullimin e tregut të punës, Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 80/2010, në dispozicion në: <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/89477/102807/F-392019526/Labour%20Market%20Regulation.pdf>

<sup>15</sup> <https://beleske.com/sta-je-zapravo-cuveni-biro/>

<sup>16</sup>

gjatë punësimit, në përputhje me planin individual të punësimit, dhe të paktën një herë në tre muaj, si dhe në çdo thirrje të Shërbimit kombëtar.<sup>17</sup>

## Mali i Zi

Në Malin e Zi, në mënyrë identike me metodën e regjistrimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, personat e papunë paraqiten personalisht në njësitë e Entit për punësim, në varësi të vendbanimit të punëkërkuarit.

Personi i papunë regjistrohet në regjistrin e personave të papunë në Entin për punësim, sipas vendbanimit, respektivisht vendqëndrimit. Personat e papunë janë të obliguar që të përgjigjen në çdo thirrje të Entit për punësim, dhe të paktën një herë në 45 ditë personalisht me qëllim që të përgatiten për punësim. Thirrja bëhet përmes ftesës me shkrim ose me telefon, për të cilën bëhet një shënim me shkrim. Nëse personi i papunë nuk paraqitet në Entin e punësimit brenda periudhës së specifikuar, atëherë ndërpritet mbajtja e evidencës për të. Në këtë rast, personi i papunë nuk mund të ri regjistrohet në Entin për punësim brenda 6 muajve nga dita kur ai/ajo është larguar nga evidenca.

Punëkërkuarit e tjerë regjistrohen si punëkërkuar të tjerë, sipas vendbanimit, respektivisht vendqëndrimit. Punëkërkuarit e tjerë paraqiten te Enti për punësim të paktën një herë në katër muaj. Punëkërkuar të tjerë janë ata që nuk konsiderohen të papunë dhe të cilët mund të aplikojnë në Entin për punësim për të siguruar këshilla dhe informacione mbi zhvillimin e karrierës dhe menaxhimin dhe ndërmjetësimin në punësim.<sup>18</sup>

Por ajo që e veçon Malin e Zi janë masat që ndërmerren për të përfshirë grupe të margjinalizuara në programet e punësimit. Prandaj, është veçanërisht e rëndësishme që të theksohet se një nga masat për të arritur

<sup>17</sup> Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 36/2009, 88/2010, 38/2015, 113/2017 dhe 113/2017, në dispozicion në: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_zaposljavanju\\_i\\_osiguranju\\_za\\_slucaj\\_nezaposlenosti.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_zaposljavanju_i_osiguranju_za_slucaj_nezaposlenosti.html)

<sup>18</sup> Ligji për ndërmjetësim në punësim dhe të drejtat në rast të papunësisë, Gazeta zyrtare e Malit të Zi, nr. 024/19 nga 22.04.2019, në dispozicion në: <http://www.zzzcg.me/wp-content/uploads/2019/11/Zakon-o-posredovanju-pri-zaposljavanju-i-pravima-za-vrijeme-nezaposlenosti-2.pdf>


një nga qëllimet e Entit për punësim të Malit të Zi, e ka të bëjë me rritjen e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në programet e politikave aktive të punësimit, është angazhimi i një bashkëpunëtori për përfshirjen sociale të romëve dhe egjiptianëve në fushën e punësimit, d.m.th. ndërmjetësues për punësim.<sup>19</sup>

Roli i ndërmjetësuesit është të shkojë në terren, në komunitetet e banuara nga grupi i synuar, në mënyrë që t'i informojë ata për të drejtat e tyre, rolin e Entit të punësimit, kuptimin dhe mënyrën e paraqitjes në evidencën e personave të papunë. Detyrat e këtij personi përfshijnë edhe sigurimin e ndihmës së drejtpërdrejtë në procesin e regjistrimit në evidencën e Entit, përfshirjen në politikat aktive të punësimit si dhe programe të tjera, për t'i inkurajuar ata që të jenë të saktë dhe të rregullt gjatë paraqitjes për evidencë, të sigurojë ndihmë të drejtpërdrejtë gjatë proceseve të kërkimit punë.

## Shfaqja grafike

Bazuar në informacionet e mësipërme, grafikët e mëposhtëm japin pasqyrë se sa vende nga rajoni kërkojnë nga punëkërkuessit aktivë që personalisht të konfirmojnë statusin e tyre të, ose ofrojnë edhe metoda alternative, si dhe çfarë afate parashikojnë për konfirmimin e statusit të tillë.


**Grafiku 1:** Mënyra e konfirmimit të statusit të personave të papunë si punëkërkuess aktiv në shërbimet shtetërore për punësim në rajon



<sup>19</sup> Akcioni plan za socialnu inkluziju Roma i Egipcana 2017-2020, në dispozicion në: <http://uom.me/wp-content/uploads/2018/01/Model-LAP-a-za-socialnu-inkluziju-Roma-i-Egip%C4%87ana-2017-2020.pdf>



**Grafiku 2:** Periudha të konfirmimit të statusit të personave të papunë si punëkërkuës aktiv në shërbimet shtetërore për punësim në rajon



Lidhur me Grafikun 2, Bosnja dhe Hercegovina përfshihet në kategoritë me 30 ditë dhe 45 ditë, duke pasur parasysh se afati varet nga beneficionet që ata shfrytëzojnë nga shteti, përkatësisht 30 ditë nëse ata përdorin të drejtën për kompensim financiar dhe sigurimin e pensionit dhe sigurimit invalidor, ndërsa 45 ditë nëse ata ushtrojnë të drejtën e sigurimit shëndetësor.

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke u bazuar në përvojën e mëparshme të KRNМ në kuadër të Garancisë rinore, përvojat krahasuese nga vendet e tjera evropiane, si dhe në interes të të gjithë të rinjve në vend, është e nevojshme të ndryshohet neni i mësipërm i Ligjit për punësimin dhe sigurim në rast të papunësisë, konkretisht në nenin 59-a. Ne propozojmë ndryshime që mund të zbatohen të paktën në mënyrë alternative, dhe në rastin më të mirë edhe në mënyrë kumulative. Aktualisht, paragrafi 1 i nenit thotë:

“Personi i papunë është i detyruar personalisht të paraqitet në Agjenci çdo 30 ditë dhe të dëshmojë se në mënyrë aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit, ndërsa një person tjetër që kërkon punë çdo gjashtë muaj.”

Ne besojmë se regjistrimi i parë në qendrat e punësimit duhet të bëhet me prani personale të personit që regjistrohet në të njëjtën. Megjithatë, për mendimin tonë, Ligji duhet të plotësohet dhe të përmbajë një mundësi për të konfirmuar statusin e një punëkërkuesi aktiv, përveç përmes pranisë personale në mjediset e qendrave të punësimit të APRMV, kjo të mund të kryhet edhe në mënyra të tjera alternative:

- ◆ Konfirmim elektronik i statusit të punëkërkuesi aktiv
- ◆ Konfirmim i statusit të punëkërkuesi aktiv përmes një përfaqësuesi të autorizuar
- ◆ Ekipeve mobile APRMV që do të shkonin dy herë në muaj në vendbanime të cilat janë 10 ose më shumë kilometra larg qendrës ekzistuese të punësimit

Në përputhje me përpjekjet globale dhe atyre nacionale për digjitalizimin e shërbimeve publike, ne propozojmë të futet mundësia që regjistrimi i personave të papunë të bëhet në mënyrë elektronike. Aktualisht, në pjesën për “shërbime elektronike” të portalit [uslugi.gov.mk](http://uslugi.gov.mk) nuk është renditur shërbimi “paraqitja e një personi të papunë”.

Në këtë pjesë, renditet shërbimi “Lëshimi i një certifikatë për një person të regjistruar të papunë”, por, edhe pse ky shërbim është i përfshirë në ato elektronike, në informacionet në lidhje me shërbimin thotë se aplikacioni me dokumentet mund të dorëzohet në sportel dhe me gojë, ndërsa në mënyrën e dhënies së shërbimit thuhet se “merret personalisht”. Për më tepër, nuk ka informacione në dispozicion për ofrimin e mundshëm elektronik të këtij shërbimi, përveç asaj që thuhet se për marrjen e shërbimit kërkohet një nivel i ulët i eID.<sup>20</sup>

Për më tepër, në shërbimet “Masat aktive të punësimit” dhe “Shërbimet e punësimit” të ofruara nga Agjencia e punësimit, në pjesën “mënyrat e ofrimit të shërbimit” thuhet se ato duhet ngritur personalisht, gjegjësisht nuk ka mundësi për dorëzim elektronik.

Konfirmimi elektronik i statusit të punëkërkesve aktivë do të thjeshtojë dhe do të bëjë më të lirë procesin e regjistrimit për të rinjtë që janë ekonomikisht të dobët dhe të papunët, veçanërisht nga zonat rurale, si dhe do të zvogëlojë barrën administrative për punonjësit në qendrat e punësimit (do të ulë numrin e personave që presin në radhë dhe tensionin që të njëjtat e shkaktojnë, por edhe mund të jenë gjithashtu një burim i mundshëm i sëmundjeve infektive si me rastin e pandemisë së koronavirusit). Gjithsesi, kjo mundësi do të përdorej paralelisht me atë ekzistuese dhe çdo person i papunë do të kishte mundësinë të zgjedhë se cila mënyrë është më e pranueshme për të.

---

<sup>20</sup> Nivelet e eID i referohen niveleve të besueshmërisë së konfirmimit të identifikimit elektronik në procesin e regjistrimit dhe hyrjes. SEN (Sistemi me një hyrje - Single Login System) mbështet nivelet e mëposhtme eID: Profili bazë i përdoruesit - emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi; Nivel i ulët i eID - Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi dhe Niveli i lartë i eID - emri i përdoruesit, fjalëkalimi dhe certifikata për nënshkrim digjital. Për të marrë një e-shërbim, duhet të keni një eID të paktën në nivelin në të cilin ai shërbim shënohet në pjesën publike të Portalit.

Niveli i ulët i eID do të thotë që në procesin e regjistrimit në një moment identiteti fizik është kontrolluar dhe konfirmuar nga prania juaj personale, duke bashkangjitur një dokument të vlefshëm të identifikimit personal dhe me verifikimin dhe konfirmimin plotësues të të dhënave tuaja në Regjistrin qendror të popullsisë (RQP/CRN). Bazuar në identitetin tuaj të verifikuar fizik, krijohet eID-i juaj i nivelit të ulët.

Hyrja me profil të ulët eID nënkupton vërtetimin me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Kjo qasje konsiderohet të ketë një nivel të ulët të kredibilitetit sepse ekziston një probabilitet i caktuar që dikush të zbulojë emrin tuaj të përdoruesit dhe fjalëkalimin.

Burimi: [uslugi.gov.mk](http://uslugi.gov.mk)

Në përputhje me atë më sipër, rekomandojmë të prezantojmë mundësinë për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë qytetarët në shërbimet e APRMV, dy herë në muaj të kryhen vizita në terren nga APRMV në mjedise që janë më shumë se 10 km larg nga qendra më e afërt e punësimit. Vizitat e tilla do të lehtësonin në mënyrë të ndjeshme qasjen e kategorive më të rrezikuara në shërbimet e ofruara nga Agjencia dhe nuk do t'i ekspozonin ato ndaj harxhimeve plotësuese.

Ne besojmë se janë të nevojshme ndryshime në afatin e regjistrimit e personave të papunë, respektivisht zgjatja e afatit nga 30 ditë në 3 muaj. Në përputhje me praktikën rajonale prej tre muajve, përveç kësaj, personave të papunë që jetojnë në zonat rurale, kjo mundësi do t'ju ndihmonte që në mënyrë të ndjeshme të ulin barrën financiare dhe do t'i inkurajonte që ata të paraqiten në mënyrë të rregullt dhe t'i përdorin masat e ofruara nga Agjencia. Ne rekomandojmë që kushtet për ripërtëritjen e statusit të përshtaten me programet e ofruara nga Agjencia.

Për më tepër, për shkak të sfidave me të cilat përballen përdoruesit të Garancisë rinore, ne e konsiderojmë të një rëndësie të veçantë sigurimin e një kornize ligjore për vetë masën në të njëjtin ligj.

Në drejtim të rritjes së drejtësisë së shërbimeve të ofruara për personat e papunë, është e nevojshme të ndryshohet paragrafi 2 i të njëjtit nen, gjegjësisht shkurtimi i afatit në të cilin personat e papunë të cilët nuk janë paraqitur brenda 30 ditëve në Agjencinë e punësimit atyre nuk u lejohet që përsëri të ri regjistrohen si të papunë. Tani për tani, këtyre personave nuk u lejohet që të ri regjistrohen në Agjenci për një periudhë prej një viti pasi që kanë humbur mundësinë për t'u regjistruar. Duke marrë parasysh specifikat e kësaj kategorie të prekshme, nevojën e tyre për mbështetje institucionale, por edhe përvojat rajonale, ne propozojmë që kjo periudhë, në vend të një viti, të zgjasë 6 muaj.

## ZGJIDHJA LIGJORE

Bazuar në atë që është theksuar më sipër, propozojmë ndërhyrje në tekstin e nenit 59 të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë. Sipas mendimit tonë, ndërhyrja në tekst do të ishte si vijon:

### Neni 59-a

Personi i papunë është i detyruar të regjistrohet tek Agjencia çdo tre muaj dhe të dëshmojë se ai/ajo në mënyrë aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit, ndërsa një person tjetër i cili kërkon punë në çdo gjashtë muaj.

Regjistrimi i personit të papunë mund të bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- ◆ Konfirmim elektronik i statusit të punëkërkuarit aktiv
- ◆ Verifikimi i statusit të punëkërkuarit aktiv përmes një përfaqësuesi të autorizuar
- ◆ Duke u paraqitur në ekipet mobile të APRMV të cilët 2 herë në muaj vizitojnë vendbanimet që janë 10 ose më shumë kilometra larg nga një qendër ekzistuese e punësimit

Personi i papunë i cili nuk arrin të përmbushë obligimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni brenda tre muajsh pas skadimit të periudhës së paraqitjes të caktuar në planin individual të punësimit, fshihet nga evidenca e personave të papunë dhe mund të aplikojë përsëri zbatohen pas skadimit të gjashtë muajve ndërsa përdoruesit e të drejtave në bazë të papunësisë e humbin të drejtën.

### Neni 59-b (shtohet)

Konfirmimi elektronik i statusit të punëkërkuarit aktiv kryhet në ueb faqen e Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (<https://av.gov.mk>).

### Neni 59-c (shtohet)

Konfirmimi i statusit të punëkërkuarit aktiv përmes një përfaqësuesi të autorizuar kryhet duke i dhënë autorizim për përfaqësim (prokurë/autorizim) një personi tjetër fizik nga personi i papunë në përputhje me dispozitat e Ligjit për detyrime.<sup>21</sup>

### Neni 59-d (shtohet)

Konfirmimi i statusit të një punëkërkuari aktiv të ekipet e lëvizshme të APRMV kryhet ekskluzivisht në vendbanimet që janë 10 ose më shumë kilometra larg nga qendra më e afërt ekzistuese e punësimit.

---

<sup>21</sup> Ligji për detyrime, Gazeta zyrtare nr. 18/01, në dispozicion në: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-obligatsionite-odnosi-20-02-2001.pdf>

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

331.5-053.6(497.7)

КУЛАКОВ, Филип

Иницирај шанса за сите : фер пристап до можности за сите невработени : документ за јавна политика / [автори Филип Кулаков, Весна Радиновска]. - Скопје : Национален младински совет на Македонија, 2021. - [27] стр. ; 30 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65879-8-7

1. Радиновска, Весна [автор]

а) Пазар на труд -- Млади -- Вработување -- Македонија

COBISS.MK-ID 52896005

